

MANUAL

Diskriminimi i
shumëfishtë i personave
LGBTI + dhe Rom/
Egjiptian në Shqipëri

MANUAL

Diskriminimi i shumëfishtë i
personave LGBTI + dhe Rom/
Egjiptian në Shqipëri

IMPRESSUM

Botuesi:

Civil Rights Defenders

Për Botuesin:

Goran Miletić

Drejtor për Europën

Autorë:

Xheni Karaj

Elvis Popaj

Dizajni:

Marko Kovačevski

Kopje:

100

MANUAL

Diskriminimi i shumëfishtë i
personave LGBTI + dhe Rom/
Egjiptian në Shqipëri

SHKURTESAT

<i>Aleanca LGBT</i>	<i>Aleanca kundër diskriminimit të personave LGBT</i>
<i>AMA</i>	<i>Autoriteti i Mediave Audiovizive</i>
<i>Ambasada PINK</i>	<i>Ambasada PINK/Pro LGBT Shqipëri</i>
<i>AP</i>	<i>Avokati i Popullit</i>
<i>CRD</i>	<i>Civil Rights Defenders</i>
<i>HIV</i>	<i>Virusi i Imunodeficiencës Njerëzore</i>
<i>IST</i>	<i>Infeksionet Seksualisht të Transmetueshme</i>
<i>KDNj</i>	<i>Komisioni për të Drejtat e Njeriut</i>
<i>KMD</i>	<i>Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi</i>
<i>KRS</i>	<i>Kirurgji (ndërhyrje kirurgjikale) për Ricaktimin e Seksit</i>
<i>LGBTI</i>	<i>(Persona) lesbike, gei, biseksualë, transgjitorë dhe interseks</i>
<i>LMD</i>	<i>Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi</i>
<i>MAS</i>	<i>Ministria e Arsimit dhe Sportit</i>
<i>MB</i>	<i>Ministria e Brendshme</i>
<i>MD</i>	<i>Ministria e Drejtësisë</i>
<i>MMSR</i>	<i>Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë</i>
<i>MSh</i>	<i>Ministria e Shëndetësisë</i>
<i>OBSH</i>	<i>Organizata Botërore e Shëndetësisë</i>
<i>OMSA</i>	<i>Open Mind Spectrum Albania</i>
<i>OSIGj</i>	<i>Orientimi Seksual dhe Identiteti Gjitor</i>
<i>Pro LGBT</i>	<i>Të gjithë të bashkuar pro kauzës LGBT</i>
<i>TZH</i>	<i>Terapia për zëvendësimin e hormoneve</i>

TABELA E PËRMBAJTJES

<i>Shkurtesat</i>	2
<i>1. Qëllimi i Manualit</i>	4
<i>2. Terminologji</i>	4
<i>3. Situata e komunitetit LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian në Shqipëri</i>	5
<i>3.1. Dalja hapur tek familjarë dhe miqtë</i>	6
<i>3.2. Sfidat për punësim</i>	7
<i>3.3. Sfidat për të aksesuar edukimin</i>	7
<i>3.4. Sfidat për të siguruar strehim dinjitoz</i>	8
<i>4. Çfarë është diskriminimi i shumëfishtë?</i>	9
<i>5. Përse është e nevojshme qasja ndërsektorale ndaj diskriminimit?</i>	9
<i>5.1. Kuadri ligjor në Shqipëri mbi dhunën dhe diskriminimin</i>	10
<i>6. Si dhe ku mund të raportojmë diskriminimin e shumëfishtë?</i>	13
<i>7. Lista e organizatave kryesore që ofrojnë shërbime për komunitetin LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian në Shqipëri:</i>	14
<i>8. Bibliografia</i>	18

1. QËLLIMI I MANUALIT

Ky manual është zhvilluar në kuadër të projektit rajonal “Fuqizimi i personave LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian si dhe i organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi”, që po zbatohet nga Civil Rights Defenders në partneritet me Aleancën LGBTI.

Ky udhëzues do t’i shërbejë personave të komunitetit LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian, për tu informuar mbi konceptin dhe pasojat e diskriminimit të shumfishtë si dhe të drejtat që legjislacioni shqiptar ofron për t’i mbrojtuar ata nga diskriminimi, krimet dhe gjuha e urrejtjes, si edhe për të njohur e për të patur akses në shërbimet e ngritura nga organizatat LGBTI + për t’i ardhur në ndihmë komunitetit LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian.

2. TERMINOLOGJI

LGBTI+: Ky është akronimi për “lezbike, gej, biseksual dhe transgjinnor”. Duhet të kemi parasysh që me kalimin e kohës dhe me zhvillimet që shoqëria dhe gjuha pëson, kjo listë akronimesh është pasuruar dhe zgjeruar.

Lezbike: Një grua ose vajzë e cila tërhiqet emocionalisht, fizikisht dhe seksualisht nga një grua tjetër.

Gej: Një mbiemër që ka zëvendësuar gjerësisht fjalën “homoseksual” kur i referohemi meshkujve që janë seksualisht dhe emocionalisht të tërhequr nga meshkuj të tjerë.

Biseksual: Individët që tërhiqen emocionalisht dhe seksualisht nga të dyja sekset. Nuk supozon ose hamendëson jo-monogami. Disa njerëz identifikohen si “bi” në vend të biseksualë.

Transgjinnor: Termi transgjinnor përdoret si një term ombrellë për personat që e ndajnë ose e shprehin gjininë e tyre ndryshe nga pritshmëritë e shumicës bazuar në seksin e tyre biologjik. Ky grupim mund të përfshijë personat transeksualë ose ata që vishen ‘ndryshe’.

Transeksual: Ky term përdoret për persona të cilët duan të jetojnë / t’i përkasin një gjinie të ndryshme nga ajo që u është përcaktuar kur lindën. Këta persona mund të kërkojnë ndihmë mjekësore duke marrë hormone ose kryer ndërhyrje kirurgjikale për të jetuar sipas gjinisë me të cilën ata identifikohen. Në të shumtën e rasteve, ndjesia e përkatësisë në gjininë e kundërt nga ajo e regjistruar në lindje përjetohet gjatë të gjithë jetës.

Tranvestit: Ky është një term i papërshtatshëm, i cili konsiderohet ofendues për shumë njerëz. Në të kaluarën, ky term përdorej kryesisht për burra të cilët visheshin dhe silleshin si gra për qëllim të përfitimit emocional ose seksual.

Queer: Është një fjalë që njerëzit e përdorin për të përshkruar identitetin e tyre gjinnor i cili nuk konformohet me standartet sociale dhe normat tradicionale të gjinisë. Queer mund të vetëquhen personat gej, lezbike, biseksual, straight etj.

Interseks: Interseksualiteti është një term ombrellë për personat që lindin me ndryshime në karakteristikat gjinore, kromozome dhe/ose hormone, të cilat mund të mos përkojnë me pritshmërinë shoqërore dhe mjekësore. Më konkretisht, personat interseksualë lindin me karakteristika fizike ose biologjike të gjinisë (si anatomia seksuale, organet riprodhuese, strukturat hormonale dhe/ose strukturat kromozomale) që nuk përputhen me përkufizimet tipike për trupat e meshkujve ose të femrave. Ndonjëherë, kur lind një bebe, ajo lehtësisht mund të identifikohet si interseksuale nga karakteristikat trupore. Ka raste që foshnjat interseksuale kanë organe gjenitale të jashtme që duken qartësisht si organe femërore ose mashkullore, por organet gjenitale të brendshme mund të jenë të ndryshme, të keqformuara ose mund të mungojnë. Ndaj, në disa raste, një trup interseksual mund të zbulohet gjatë fëmijërisë, në pubertet, madje edhe gjatë jetës si i rritur.¹

Heteroseksual: Ky term u referohet personave të cilët tërhiqen emocionalisht, fizikisht dhe seksualisht nga persona të seksit të ndryshëm.

Homoseksualiteti: Homoseksualiteti është tërheqja fizike, emocionale ose seksuale ndaj personave të të njëjtit seks. Duke qenë se ky term është lidhur me shumë stereotipe negative dhe paragjykime në shoqërinë tonë, termat gej ose lezbike janë më shumë të rekomanduar kur i referohemi personave të cilët tërhiqen nga i njëjti seks.

Homofobi: Ky term i referohet frikës, zemërimit, urrejtjes, mostolerimit dhe mospranimit të personave LGBTI+.

Homofobi e brendësuar (interiorizuar): Homofobia e brendësuar dhe shtypja ndodh tek personat homoseksual, lezbike, biseksualë, dhe madje edhe heteroseksualëve, të cilëve i është mësuar se heteroseksualiteti është normë dhe “mënyra e saktë e të qenurit”. Personat LGBTI+ në disa raste përvetësojnë mesazhet negative që pjesa tjetër e shoqërisë projekton ndaj tyre. Disa persona LGBTI+ vuajnë nga shqetësime mendore, si rezultat i kësaj.

Dalja hapur / Dalja nga dollapi: Procesi i njohjes, ndërgjegjësimit dhe pranimit të orientimit jo-heteroseksual ose identitetit gjinnor me veten dhe pastaj ndarja me të tjerët. Fillimisht, shumë të rinj LGBTI+, krijojnë barrierë emocionale kundrejt të njohurve të tyre, miqve dhe familjarëve duke pretenduar (konkretisht ose nëpërmjet heshtjes) se janë heteroseksualë.

Dalja hapur zakonisht ndodh me etapa, dhe është një proces jo linear. Termi i daljes nga dollapi është marrë dhe përkthyer direkt nga gjuha angleze duke qënë se në shqip nuk ekziston një term i tillë.

¹https://www.undp.org/content/dam/albania/img/Publications/Intersex%20Research%20Study%20UNDP%202017_AL.pdf

Seksi biologjik: Seksi biologjik i referohet ndarjes së njerëzve në meshkuj dhe femra bazuar në disa karakteristika biologjike, të tilla si: kRom/Egjiptianozomet, hormonet, ose organet gjenitale.

Shprehje gjinore: Shprehja gjinore i referohet mënyrave se si shprehet gjinia, zakonisht përmes pamjes, veshjes, manierizmave etj. Shprehja gjinore bazohet te normat kulturore dhe ndryshon në vende dhe kontekste të ndryshme. Zakonisht është një zgjerim i identitetit gjinor, mënyra që ka dikush për të qenë burrë, ose grua.

Identiteti gjinor: Ky term i referohet përjetimit të brendshëm psikologjik të gjinisë tek një person; gjini e cila mund të përputhet ose jo me seksin e regjistruar pas lindjes. Identiteti gjinor është i ndryshëm nga orientimi seksual.

Rolet gjinore: Rolet gjinore janë seti i roleve dhe sjelljeve të lidhura me të qenit femër ose mashkull nga një shoqëri e caktuar. Rolet gjinore, pra mënyra se si shoqëria pret se duhet të sillet dhe të ndihet një femër dhe një mashkull, janë të ndryshme në kultura të ndryshme por dhe në periudha kohore të ndryshme.

Orientimi seksual: Tërheqje seksuale e natyrshme. Priorja ose aftësia për të zhvilluar marrëdhënie intime emocionale ose seksuale me njerëz që i përkasin të njëjtës gjini, gjinisë së kundërt apo më shumë se një gjinie. Ky term këshillohet të përdoret në vend të “preferencë seksuale” ose terminologjive të tjera jo të përshtatshme.

Parada e Krenarisë shpesh edhe Parada Gej: Event në të cilin komuniteti LGBTI+ dhe mbështetësit e tyre parakalojnë (shpesh duke ecur në këmbë) për të shprehur krenarinë e tyre të të qënurit gej, lesbike, transgjitorë, biseksualë. Krenaria për të dalë hapur gjatë këtij aktiviteti konsiston në faktin që komunitetit LGBTI+ i është dashur të luftojë me dekada për njohjen e te drejtave të barabarta si dhe për faktin që mos njohja e tyre si pjesë e barabartë e shoqërisë e ben këtë komunitet vulnerabël. Këto parakalime shpesh kanë formën e një feste ose proteste, por në mjaft raste ata janë thjesht parakalime apo manifestimeve simbolike për të kërkuar të drejtat themelore të cilat ju mohohen.

3. SITUATA E KOMUNITETIT LGBTI+ DHE ROM/EGJIPTIAN NË SHQIPËRI

Edhe pse vitet e fundit ka pasur zhvillime të rëndësishme sidomos në fushën e legjilacionit rreth mbrojtjes së të drejtave të komunitetit LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian, shoqëria shqiptare vazhdon të ketë nivele të larta të racizmit, homofobisë dhe transfobisë. Komuniteti LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian në veçanti përballen me shumë sfida gjatë përditshëmrisë së tyre. Diskriminimi i dyfishtë është shumë i përhapur dhe shumë shpesh janë vetë institucionet shtetërore ata që ushtrojnë praktika diskriminuese ndaj komunitetit LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian.

Sipas studimit “Perceptimet e opinionit publik ndaj komunitetit LGBTI+” realizuar nga National Democratic Institution (NDI); 48% e popullsisë në Shqipëri mendon se homoseksualiteti është sëmundje.²

Pjesa më e madhe e komunitetit Rom/Egjiptian dhe LGBTI+ ndihen të detyruar të fshehin orientimin e tyre seksual dhe/ose identitetin gjinor (SOGI) nga ata që i rrethojnë, duke përfshirë familjet, miqtë dhe komunitetin ku jetojnë.

Punësimi është një nga sfidat kryesore me të cilat përballen pjesëtarët e komunitetit Rom/Egjiptian dhe LGBTI+. Situata është rënduar akoma më shumë si pasojë e pandemisë së Covid 19. Në studimin e fundit të realizuar nga Aleanca LGBTI+ “**Situata e Komunitetit LGBTI+ gjatë pandemisë së Covid- 19**” rezulton që **1 në 2 persona LGBTI+ kanë humbur vendin e punës gjatë 2020**³.

Gjithashtu, studimi i organizatës Rome “T’REJA” rreth ndikimit të Covid 19 në komunitetin Rom thekson se **62 % e fëmijëve Rom nuk kanë akses në mësimdhënien online për shkak të mungesës së pajisjeve kompjuterike dhe internetit**. Sipas dëshimeve të komunitetit Rom pranë organizatës T’REJA varfëria e familjeve Rome është thelluar akoma më shumë gjatë Covidit dhe mbështetja nga ana e institucioneve shtetërore ka qenë e papërfillshme, duke mos i mundur anëtarëve të komunitetit Rom plotësimin e nevojave bazë për ushqim, strehim dhe medikamente.⁴

Në institucionet arsimore personat LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian janë subjekte të ngacmimit dhe abuzimit verbal dhe fizik. Është shumë e rëndësishme që mësuesit dhe nxënësit të trajnohen dhe informohen mbi të drejtat e komunitetit LGBT dhe Rom/Egjiptian dhe ligjin kundër diskriminimit në mënyrë të tillë që në shkollat shqiptare të krijohet një ambjent i sigurtë dhe pranues për këto komunitete.

Marrja e shërbimeve shëndetësore publike, përfshirë shërbimet për HIV, është shqetësim real për Komunitetin LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian. Mungesa e aksesit në kirurgjinë e ricaktimit të seksit (KRS) është një barrier konstante për komunitetin transgjitor. Në shumë raste mjekët nuk u japin ndihmë mjekësore grave transgjitorë dhe Rom/Egjiptiane dhe një përfaqësues i organizatës Aleanca LGBT duhet t’i shoqërojë ata në mënyrë që mjekët të marrin seriozisht çështjen. Kemi pasur raste kur mjekët nuk donin të preknin me dorë gratë transgjitorë dhe Rom/Egjiptiane pasi kishin frikë mos merrnin ndonjë sëmundje. Në një nga rastet, mjeku i tha një përfaqësuesi të stafit tonë: “Pse nuk i lini këto njerëz të vdesin”.⁵

²National Democratic Institute (2015) Public Opinion Poll Eastern Balkans on LGBTI issues (Anketim publik në Ballkanin Perëndimor për çështjet LGBTI), gjendet në: https://www.ndi.org/LGBTI_Balkans_poll

³<https://www.historia-ime.com/lgbt/situata-e-lgbti-gjate-pandemise-rritje-e-papunesise-dhe-nevojës-per-strehim-e-sherbime/>

⁴Spot I realizuar nga Qendra T’REJA <https://www.facebook.com/1630624913618299/posts/4045640228783410/>

⁵<https://www.aleancalgbt.org/lajme/62-publikimi-i-raportit-vjetor-te-organizatave-kunder-diskriminimit-te-komunitetit-lgbt-ne-shqiperi>

Sipas studimit të realizuar nga Aleanca gjatë periudhës së Covid 19, 11.5%⁶ e personave të cilët kanë pasur nevojë për medikamente gjatë 2020 shprehen se kanë hasur vështirësi në sigurimin e medikamenteve në kohë. Arsyet përse nuk kanë arritur të sigurojnë medikamentet në kohë, kanë qenë:

1. Mungesa në treg e ilaçeve,
2. Mungesa e transportit publik,
3. Vështirësimi për të aksesuar shërbimet pranë ISHP-së.

Gratë transgjimore dhe Rom/Egjiptiane janë një nga nën-grupet më të marginalizuara në komunitetin LGBTI+ në Shqipëri. Gratë transgjimore dhe Rom/Egjiptiane që nuk e fshehin identitetin e tyre gjinor e kanë të pamundur të punësohen. Gratë dhe vajzat transgjimore dhe Rom/Egjiptiane nuk mund të marrin dokumenta që zyrtarisht regjistrojnë gjininë e tyre të preferuar⁷. Në shumë raste ato punojnë si punonjëse të seksit për të mbijetuar.

Strehimi është një sfidë e përditshme për komunitetin LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian, sidomos për atë pjesë të komunitetit që ka bërë coming out/dalë hapur në familje dhe nuk pranohet prej tyre, ose për personat pamja e të cilëve nuk përputhet me normat gjinore, si personat transgjinor. Një pjesë e madhe e tyre i sigurojnë të ardhurat duke punuar në vende me paga minimale ose punë informale. Për shkak të pandemisë shumë prej tyre e humbën vendin e punës dhe si pasojë mbetën të pastrehë. Një pjesë tjetër e tyre u detyrua të kthehej pranë familjeve, dhe të tjerë gjetën strehim dhe mbështetje tek miqtë ose të afërmit.

Duke ju referuar pyetësorit, një shifër e konsiderueshme rreth 25.4% e të anketuarve shprehen se nuk mund të plotësojnë nevojat për strehim.

Dhuna në familje mbetet një problem shumë shqetësues për anëtarët e komunitetit LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian. Gjatë vitit 2019 pranë Aleancës LGBTI+ janë raportuar **33 raste të dhunës nga të afërmit dhe 31 raste** deklarohen se kanë përjetuar dhunë brenda në familje.

Në pjesën më të madhe të rasteve, dhuna në familje nuk raportohet tek institucionet për shkak të mungesës së besimit dhe faktit që personat e komunitetit LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian ndihen të turpëruar të bëjnë publik faktin që familja tyre i abuzon.

Gjatë periudhës Tetor-Nëntor 2020, Aleanca LGBTI zhvilloi dy fokus grupe me 10 anëtarë të komunitetit LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian të cilët ndanë eskperienat dhe sfidat e tyre.

Më poshtë do të trajtohen disa nga gjetjet kryesore të fokus grupeve të cilat identifikuan problematika dhe sfida shumë të ngjashme me një fokus grup të mëparshëm të organizuar nga CRD në vitin 2019. Për shembull, një gjetje mjaft domethënëse që filtrohet nga diskutimi i zhvilluar përgjatë fokus grupit në Shqipëri gjatë 2019 ishte graviteti që mbart varfëria si një prej burimeve kryesore të shumë prej problemeve me të cilat përballen të tre grupet. Nga arsyetimi i pjesëmarrësve dhe përvojat e tyre të drejtpërdrejta rezulton se varfëria është edhe shkak kryesor i diskriminimit. Kjo reflektohet në faktin që dallohen diferenca në marrëdhënien midis individëve që janë pjesë e këtyre grupeve dhe shumicës së popullatës, të kushtëzuara nga gjendja ekonomike e individit. Gjithashtu, veçori që theksohej gjatë diskutimit në fokus-grup, si shprehje e dallimeve midis romëve dhe personave LGBTIQ+ në Shqipëri, është mënyra se si trajtohen prej tjetrit që nuk është pjesë e këtyre grupeve. Për shembull, një aktiviste e të drejtave të personave LGBTIQ+ me një përvojë të gjatë në organizata të ndryshme jo fitiprurëse, u shpreh: “Kam vënë re se qasja e profesionistëve ndaj komunitetit LGBTI+ dhe atij rom/egjiptian është e ndryshme. Zakonisht në ambiente ku ka profesionistë dhe flitet për komunitetin rom dhe egjiptian, ata përpiqen të jenë të kujdesshëm, kurse lidhur me komunitetin LGBTIQ+ kjo pothuajse nuk ndodh”.⁸ Shumë nga çështjet e diskutuara në 2019 duket të jenë shumë relevante dhe për situatën gjatë 2020.

3.1. DALJA HAPUR TEK FAMILJARË DHE MIQTË

Pjesëmarrësit në fokus grup në fillim u pyetën në lidhje me daljen hapur dhe nëse i kishin treguar familjarëve rreth orientimit të tyre seksual. Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve u shprehën se pasi ndihen të përjashtuar nga shoqëria si anëtarë të komunitetit Rom/Egjiptian nuk kanë dashur të përjashtohen gjithashtu nga komuniteti i tyre duke dalë hapur dhe si pjestarë të komunitetit LGBTI+. Si rrjedhojë kanë vendosur ta mbajnë të fshehtë orientimin e tyre seksual. Sipas tyre, familjarët nuk do t'a pranonin kurrë faktin që janë LGBTI+, dhe se ata nuk do të donin të lëndonin prindërit e tyre.

Ndërsa disa nga pjesëmarrësit transgjinorë përmendën se prindërit e tyre ishin në dijeni të identitetit të tyre gjinor. Pjesëmarrësit që nuk i ishin hapur familjarëve, e kanë bërë këtë sepse;

⁶Idem 3.

⁷Gender recognition in Albania <https://www.lgbti-era.org/one-stop-shop/albania>

⁸Raporti analitik mbi gjetjet e studimit cilësor mbi situatën e personave LGBTI në Shqipëri, Serbi dhe

Maqedoninë e Veriut: <https://www.historia-ime.com/wp-content/uploads/2019/11/Roma-LGBTI-analytical-report-CRD-shqip.pdf>

“Do të më nxirrin nga shtëpia. Pse jo edhe të më abuzonin fizikisht” shprehet M.

“Kisha frikë nga babi se është fanatik dhe nuk dua që ta humbas familjen time” tha H.

Këto thënie nga pjesëmarrësit në fokus grup theksojnë qëndrimet homofobike që ekzistojnë në shoqërinë shqiptare, veçanërisht në qytetet e vogla, dhe zonat rurale.

Individët që kanë dalë hapur tek prindërit folën rreth reagimeve të familjarëve dhe miqve kundrejt “daljes së tyre hapur”. Njëra nga vajzat transgjimore dhe rome u shpreh që pasi familja mori vesh identitetin e saj gjinor u dhunua fizikisht nga vëllezërit të cilët e nxorrën me dhunë nga shtëpia dhe nuk e lejojnë të takojë më të ëmën, nipërit dhe mbesat.

Ajo u shpreh: “Për të takuar mamin duhet ta marr fshehurazi në telefon dhe ta takoj pa e marrë vesh babai dhe vëllezërit.”

A, një tjetër vajzë transgjimore tregoi që prindërit kanë dashur ta martonin me dhunë në moshën 16 vjeçare dhe si pasojë është detyruar të largohet nga shtëpia

3.2. SFIDAT PËR PUNËSIM

Në lidhje me punësimin të gjithë pjesëmarrësit në fokus grupe shprehën vështirësitë që hasin për të gjetur punë si pasojë e faktit që i përkasin komunitetit LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian.

“V. rrëfeu se ka kërkuar punë në shumë vende, punë të zakonshme, edhe punë krahu, por edhe aty është diskriminuar.”

Një tjetër pjesëmarrës në fokus grup Anxhelo shprehet se: “Diskriminin e kam ndjerë, kur kërkoj punë, në zyrat e punës, vërehet menjëherë diskriminimi, ka shumë racizëm në zyrat e shtetit”- shprehet ai teksa shton se kjo gjë vjen për shkak të injorancës.

“Kjo gjë më shqetëson, kudo që kam vajtur për punë, më shikojnë nga ngjyra e lëkurës, që është e dukshme dhe më diskriminojnë.”- vijon më tej ai duke treguar diskriminimin që i ndodh çdo ditë, madje tregon edhe episode dramatike teksa shprehet: “Ik mo jevg, më thonë, ma kanë thënë në sy, dhe kjo nuk është normale, sepse unë kam karakter, kam pastërti, nuk kam bërë asnjë vjedhje, dhe nuk kam bërë asnjë vepër penale.”

Një tjetër dëshmi rreth pamundësisë për tu punësuar vjen dhe nga Anxhela një grua transgjimore dhe Rom/Egjiptiane 36 vjeçare. Ajo u shpreh se: “Unë dal në rrugë dhe kërkoj para, por policia nuk të lë as të lypësh, unë nuk po bëj asnjë vepër penale, dhe më thonë që nëse lyp do të çojmë në burg, unë kam lypur para gjithë jetën, dhe ata nuk mund të më ndalojnë për të kërkuar para. Unë u kam thënë “më gjeni një punë dhe unë nuk do të lyp më, unë pranoj punë nga Bashkia nëse me ofrohet.”

3.3. SFIDAT PËR TË AKSESUAR EDUKIMIN

Braktisja e shkollës në moshë të hershme për shkak të diskriminimit dhe bullizmit, kombinuar me faktorë të tjerë, janë një tjetër problematikë që prek fëmijët dhe të rinjtë LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian. Për rrjedhojë, një tjetër temë e rëndësishme e trajtuar gjatë fokus grupeve ishte dhe aksesin në edukim dhe eksperiencat që personat LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian kanë përjetuar në shkolla.

Pjesëmarrësit, identiteti seksual i të cilëve njihet nga mësuesit, folën rreth qëndrimeve të nxënësve dhe mësuesve ndaj tyre. Ato sollën ndër mend disa incidente në shkolla, ku ishin bërë subjekt dhune fizike dhe verbale nga nxënës dhe studentë të tjerë.

V, një transgjimore, për shembull, kujtoi se si ajo ishte abuzuar fizikisht: “më rrihnin vazhdimisht në shkollë. Më thërrisnin “pederast”. Kisha frikë t’i tregoja prindërve dhe ndjeja ankth sa herë shkoja në shkollë. Derisa një ditë vendosa ta braktisja shkollën pasi nuk duroja dot më.”

Pjesëmarrësit gjithashtu përmendën qëndrimet që mësuesit kanë pasur ndaj tyre në shkollë. Ato përfshijnë qëndrime si, tallje të hapura të studentëve, apo komente degraduese të lëshuara hapur kundër tyre.

D, transgjimore që e la shkollën në klasën e dytë kujton: “Mësuesit e kuptonin se çfarë isha unë, dhe tallshin me mua. Ato thoshin “Shikoje atë, pse flet si gocë.”

Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve e kanë braktisur shkollën jo vetëm për shkak të diskriminimit, por edhe për shkak të kushteve të vështira ekonomike.

F., grua transgjimore nga Elbasani, u shpreh se nuk e ka patur të mundur të kryejë asnjë klasë në shkollë për shkak të kushteve të vështira ekonomike në të cilat ndodhej familja e saj. Ajo sëbashku me të ëmën ka punuar qysh prej momshës 7 vjeçare duke shitur rroba në muret e spitaleve në Tiranë.

3.4. SFIDAT PËR TË SIGURUAR STREHIM DINJITIZ

Strehimi është një tjetër çështje e rëndësishme që prek komunitetet LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian dhe që u diskutua gjatë fokus grupit. Vajzat transgjimore dhe Rom/Egjiptiane që morën pjesë në fokus grup u shprehën që kanë hasur vështirësi të jashtëzakonshme për të gjetur shtëpi me qira edhe në rastet kur kishin para për të paguar. Pronarët në telefon u thonin që ishin të gatshëm t’ua jepnin banesën me qira por në momentin kur shihnin që ishin transgjimore dhe Rome nuk pranonin t’i lëshonin banesën me qira duke i përcjellë me justifikime apo edhe me sharje e ofendime. Në shumë raste janë përzënë me dhunë nga qiradhënësi pa marrë asnjë shpjegim dhe pa ua kthyer paratë mbrapsht. Pjesa më e madhe e tyre nuk kanë gjetur mbështetje as në institucionet shtetërore përsa i përket strehimit.

M. grua lesbike dhe Rom/Egjiptiane u shpreh; “Për mua ka qënë shumë e vështirë dhe është ende shumë e vështirë. Më ka ndihmuar vetëm njëherë njësia 4, por çfarë mund të bëj unë në këto kushte kur jam pa përkrahje, pa mbështetje, pa shtëpi dhe pa të ardhura. Unë marr bonus nga bashkia 7000 lek, po ku gjen sot shtëpi me 7000 lek qeraja në muaj? Ndaj jam detyruar dhe kam shkuar nëpër kazanë të mbledh kanaçe e të paguaj qiranë”. Ajo shprehet se dhe gjatë muajve të pandemisë Covid -19 është detyruar të kërkojë në kazanë duke rezikuar infektimin me virusin.

“Procedurat e Bashkisë për të marrë bonusin e qirasë janë aq të ndërlikuara sa duket sikur janë bërë apostafat për të na demoralizuar që mos kërkojmë ndihmën e tyre”, u shpreh një tjetër vajzë transgjimore e cila nuk e ka patur të mundur të plotësojë të gjitha këkresat për dokumentacion për aplikimin për bonusin e qirasë.

I vetmi rast i sukseshëm në marrjen e mbështetjes nga bashkia ka qënë ai i Anxhelës e cila e fitoi banesën sociale pas shumë viteve jetese në rrugë falë presionit të organizatave dhe institucioneve të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare⁹.

⁹Historia e Anxhelës: <https://www.historia-ime.com/ndodhi-sot/rrrefimi-i-anxheles-te-jesh-e-diskriminuar-edhe-si-rome-edhe-si-lgbt/>

4. ÇFARË ËSHTË DISKRIMINIMI I SHUMËFISHTË?

Diskriminim i shumëfishtë¹⁰ (në disa literatura quhet edhe “diskriminim i shtuar”) përfshin një situatë në të cilën diskriminimi kryhet për më shumë se një shkak, shkaqe të cilat ekzistojnë në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri. Për shembull: një grua e minoritetit Rom, mund të pësojë diskriminimin për shkak të gjinisë në një situatë të caktuar kur asaj i mohohet e drejta për punë, ndërsa në një situatë tjetër, mund të pësojë diskriminim për shkak të etnisë/racës së saj, kur i mohohet e drejta për të marrë shërbime nga një subjekt.

Diskriminimi i përbërë, në ndryshim nga diskriminimi i shumëfishtë, përfaqëson situatën kur një person vuan nga diskriminimi në të njëjtën kohë, për më shumë se një shkak ose kur një shkak i ri i shtohet diskriminimit për një shkak tjetër.

Diskriminimi i ndërthurur (ndërsektorial) përfshin një situatë në të cilën shkaqe të ndryshme veprojnë ose ndërveprojnë në të njëjtën kohë, në mënyrë të pandashme dhe të kombinuara me njëri tjetrin. P.sh., një grua mund të ndjehet e diskriminuar në punë, pasi për shkak të gjinisë ajo ka një pagë më të ulët se një burrë që punon ngjashëm me të, por në të njëjtën kohë ajo mund të anashkalohet nga të gjitha përfitimet e trajnimeve dhe të karrierës, për shkak të shtatzënisë së saj.

Guida për diskriminimin e dyfishtë e hartuar më 2010, nga Lewis në Londër¹¹, i kategorizon pak ndryshe llojet e diskriminimit. Sipas saj dallohen tre kategori të diskriminimit të shumëfishtë:

1. **Diskriminimi i shumëfishtë i zakonshëm**- karakteristika të ndryshme, në raste të ndryshme;
2. **Diskriminimi i shumëfishtë i shtuar**- karakteristika të ndryshme, i njëjti rast;
3. **Diskriminimi ndërsektorial**- karakteristika të ndryshme të kombinuara.

Sikurse konstatohet lehtë, kjo ndarje konsideron si diskriminim të shtuar, diskriminimin e përbërë ose të kombinuar. Vetë autori pranon se ka një mospërputhje në përdorimin e terminologjisë për diskriminimin e shumëfishtë¹².

Pavarësisht nga mendimet e ndryshme, shkollat teorike kritikojnë qasjen e diskriminimit me një shkak të vetëm dhe e konsiderojnë atë të pamjaftueshëm për të ofruar një mbrojtje të përshtatshme për viktimat e diskriminimit.

Ata janë të mendimit se vetë ligji duhet të bëjë një trajtim specifik të këtij rasti, pasi në përgjithësi nuk e trajton mirë këtë qasje¹³. Edhe ligji shqiptar për mbrotjen nga diskriminimi, deri në tetor të 2020 kur u miratuan disa ndryshime¹², e ka patur këtë mangësi. Mungonte përkufizimi i kësaj fushe të diskriminimit, megjithatë, praktika e zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Shqipëri, në mënyrë spontane, ka dhënë shembuj të përshtatshëm për të dalluar diskriminimin e shumëfishtë të shfaqur veçanërisht, si diskriminim i ndërthurur (ndërsektorial) ose si diskriminim të përbërë. Pas ndryshimeve ligjore të fundit, do të jetë më e lehtë për të ndërtuar një praktikë të mirëfilltë institucionale në lidhje me rastet e diskriminimit të shumëfishtë, pasi tashmë nuk mungon më baza ligjore për këtë.

Duke trajtuar diskriminimin e shumëfishtë natyrshëm lind pyetja se cilat janë shkaqet dhe faktorët që e shkaktojnë atë dhe a ndryshojnë këto raste nga rasti i diskriminimit për një shkak të vetëm. Nga studimet që kanë eksploruar këtë aspekt, nuk evidentojmë ndonjë ndryshim thelbësor mbi shkaqet dhe faktorët që e shkaktojnë diskriminimin e shumëfishtë, në raport me ato të diskriminimit në përgjithësi. Faktorët mbeten të njëjtë, ndër të cilët mbizotërojnë paragjykimet dhe stereotipat që ekzistojnë në një shoqëri.

¹⁰Shih: Tackling multiple discrimination (Practices, policies and laws), European Commission, 2007, pg. 16-17

¹¹https://www.qag-al.org/publikime/diskriminimi_shumefishte.pdf

¹²<https://www.parlament.al/ProjektLigje/ProjektLigjeDetails/51337>

¹³<https://www.coe.int/en/web/gender-matters/intersectionality-and-multiple-discrimination>

5. PËRSE ËSHTË E NEVOJSHME QASJA NDËRSEKTORIALE NDAJ DISKRIMINIMIT¹³?

1. Duke përdorur një qasje të vetme, pra jo ndërsektoriale, viktimat e diskriminimit paraqiten në terma të thjeshtëzuar. Kjo retorikë e thjeshtëzuar i bën pakicat brenda një pakice të padukshme në sferën publike - si në shoqërinë e gjerë ashtu edhe brenda grupit të pakicave. Personat e diskriminuar gjithashtu kanë të ngjarë të vuajnë nga diskriminimi brenda grupit të pakicave;
2. Personat e diskriminuar kanë më shumë të ngjarë të përjetojnë më shumë raste të diskriminimit sesa tregohet nga qasjet jo ndërsektoriale;
3. Viktimat ka më shumë të ngjarë të vuajnë nga format më të rënduara të diskriminimit, të cilat shpesh janë më intensive dhe e bëjnë personin më të cënueshëm në shoqëri;
4. Viktimat ka më shumë të ngjarë të vuajnë nga pabarazitë strukturore në shoqëri, të jenë në rrezik të varfërisë, përjashtimit social dhe marginalizimit.

5.1. KUADRI LIGJOR NË SHQIPËRI MBI DHUNËN DHE DISKRIMINIMIN

• Kushtetuta¹⁴

Kushtetuta përcakton të drejta gjithëpërfshirëse për qytetarët (neni 15) dhe garanton barazinë para ligjit, pavarësisht nga, ndër të tjera, edhe gjinia (neni 18). Gjinia mund të interpretohet në një kuptim të gjerë si një term që përfshin edhe orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Kushtetuta përcakton që kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje (neni 53), duke mos penguar shprehimisht martesat brenda të njëjtës gjini, siç bën Kodi i Familjes.

• Kodi i Familjes dhe Ligji Nr.9695, datë 19.3.2007 “Për Birësimin”, më vonë i ndryshuar.¹⁵

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë njeh të drejtën e martesës dhe familjes për të gjithë (neni 53), ndërsa Kodi i Familjes e përkufizon martesën si një institucion ndërmjet një burri dhe një gruaje, gjë që në thelb ndalon martesat brenda seksit (neni 163). Partnerët e të njëjtit seks nuk mund të birësojnë fëmijë së bashku, për shkak se një i mitur nuk mund të birësohet nga më shumë se një person përveç rastit kur këta persona janë bashkëshortë, që do të thotë burrë dhe grua (neni 242). Sipas Ligjit për Birësimin (Neni16/2), personi që bën kërkesë për birësim fëmijë duhet të plotësojë kushtet sipas Kodit të Familjes, që do të thotë të jetë në marrëdhënie bashkëshortore (neni 242). AP dhe KMD i kanë kërkuar MD të bëhen ndryshime në Kodin e Familjes, ndërsa në dhjetor 2013 organizatat e personave LGBTI+ i kërkuan MMSR të mbështeste njohjen e bashkimeve civile të personave të njëjtit seks. MMSR ia ka përcjellë kërkesën MD-së në vitin 2014. MD nuk ka bërë ndonjë hap për të amenduar Kodin e Familjes.

Njohja ligjore e partneriteteve ndërmjet personave të të njëjtit seks u mbështet edhe nga Këshilli i Evropës - Shqipëri, gjatë zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për personat LGBTI+ 2012- 2014

• Kodi Penal¹⁶

Kodi Penal u ndryshua në vitin 2013 dhe tani përfshin orientimin seksual dhe identitetin gjinor si rrethana rënduese të veprave penale (neni 50). Shpërndarja e materialeve homofobike nuk penalizohet, siç kriminalizohet për shembull shpërndarja e materialeve me përmbajtje raciste apo ksenofobike (neni 119/a/b). Kodi Penal kriminalizon gjuhën e urrejtjes vetëm për shkaqe të orientimit seksual (neni 265), duke e lënë të patrajtuar çështjen e identitetit gjinor. Kodi ndalon diskriminimin e personave nga ana e punonjësit me funksion shtetëror për arsye të orientimit seksual dhe identitetit gjinor (neni 253). Kodi Penal në Shqipërisë nuk ofron mbrojtje nga gjuha transfobike (neni 265) dhe nga nxitja tendencioze e urrejtjes homofobike dhe transfobike (neni 119/a/b); ai nuk penalizon dhunën homofobike dhe transfobike në formën e kanosjes për shkak të OSIGj (neni 84); ai penalizon punëtorët konsensualë të seksit dhe punën transseksuale si “prostitucion” (nenet 107-113); dhe i referohet marrëdhënieve të detyruara brenda seksit si “homoseksuale” (neni 105). Për sa i përket ndërhyrjeve të panevojshme mjekësore në personat interseks, Kodi Penal nuk përmban asnjë dispozitë, sepse kjo çështje trajtohet nga Ligji për Kujdesin Shëndetësor dhe Ligji për Shëndetin Riprodhues që ndalojnë çdo ndërhyrje pa pëlqimin paraprak të vetë personit, por pëlqimi në rastin e fëmijëve jepet nga prindërit ose kujdestarët e tyre ligjorë, sepse fëmijët janë të mitur dhe nuk kanë kapacitet ligjor (zotësi për të vepruar).

¹⁴Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 9904, datë 21.4.2008, ndryshuar për herë të fundit me Ligjin nr. 76/2016, datë 22/7/2016. Neni 18 thotë: Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore”, Fletorja Zyrtare: <http://www.qbz.gov.al/kushtetuta.htm>.

¹⁵Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 9062 date 8.5.2003, ndryshuar për herë të fundit me Ligjin nr. 134/2015, datë 5.12.2015, Fletorja Zyrtare: <http://www.qbz.gov.al/Kode-pdf/Kodi%20i%20Familjes-%20i%20azhurnuar%202016.pdf>.

¹⁶Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 7895, datë 27 janar 1995, ndryshuar për herë të fundit në vitin 2013, Fletorja Zyrtare: <http://www.qbz.gov.al/Kode-pdf/Kodi%20Penal-2014.pdf>.

¹⁷Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, ndryshuar për herë të fundit në vitin 2015, Fletorja Zyrtare: <http://www.qbz.gov.al/Kode-pdf/Kodi%20i%20Punes-2016-qershor.pdf>.

• Kodi i Punës¹⁷

Kodi i Punës u ndryshua në dhjetor 2015 dhe hyri në fuqi në qershor 2016. Ai ndalon diskriminimin në punësim dhe profesion për shkak të OSIGj, duke e përkufizuar diskriminimin si çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerë (neni 9). Ngacmimet morale dhe seksuale dhe komentet poshtëruese që cenojnë dinjitetin dhe personalitetin e punonjësve janë të ndaluara (neni 32). Në rastin e diskriminimit për arsye të OSIGj, punëdhënësi detyrohet të provojë se nuk ka bërë shkelje të parimit të trajtimit të barabartë, dhe në rastin e ngacmimit seksual, ligji e kalon barrën e provës tek punëdhënësi ose personi që pretendohet të ketë bërë ngacmimin.

LMD dhe Kodi i Punës përbëjnë bazën ligjore për mbrojtjen e personave LGBTI+ në fushën e punësimit. Ligjet ndalojnë diskriminimin në punësim për shkak të përkatësisë OSIGj apo në një pakicë seksuale, përfshirë edhe lajmërimet për vende pune, proceset e përzgjedhjes dhe të rekrutimit, trajnimin e punonjësve në vendin e punës dhe ndërprerjen e kontratës. Megjithatë, realiteti tregon se personat LGBTI+ janë shumë të diskriminuar në fushën e punësimit dhe dispozitat e Kodit të Punës kundër diskriminimit nuk zbatohen.

• Kodi i Procedurave Administrative¹⁸

Kodi i rishikuar i Procedurave Administrative i vitit 2015 ndalon çdo lloj diskriminimi për shkak, ndër të tjera, të gjinisë dhe OSIGj. Ky ligj siguron mbrojtjen efektive të të drejtave të personave LGBTI+ (neni 17). Për më tepër, në rastet e pretendimeve për diskriminim për shkak të OSIGj, ky ligj e kalon barrën e provës tek organi publik, siç parashikohet në LMD (neni 82).

• Ligji Nr.10221, datë 4.2.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, më vonë i ndryshuar¹⁹

Që nga viti 2010, Shqipëria ka miratuar një ligj të përgjithshëm për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD), i cili është përgjithësisht në përputhje me *acquis-in* e BE-së për barazinë²⁰. Ai “rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër” (neni 1). Diskriminimi përkufizohet si “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë” (neni 2). Ligji përfshin që nga reklamat diskriminuese, deri tek pjesëmarrja në politikë, punësimi, arsimi dhe të mirat dhe shërbimet, dhe mbulon si sektorin publik ashtu edhe privat. Ai përcakton gjithashtu strukturën kombëtare për mbrojtjen nga diskriminimi, që është KMD. LMD autorizon edhe institucionet e tjera, si Këshilli i Ministrave, MMSR, MB, MAS dhe autoritetet arsimore vendore për ta zbatuar atë. Në tetor të 2020 ndryshimet në ligj janë bërë gjithashtu për të kategorizuar diskriminimin e përsëritur ose të vazhdueshëm, ose diskriminimin e motivuar nga më shumë se një arsye si një formë serioze e diskriminimit. Gjithashtu është përfshirë dhe koncepti i gjuhës së urrejtjes. Pozicioni i Komisionerit për Diskriminim është forcuar pasi me ndryshimet e reja, të gjitha institucionet publike dhe entet private janë të detyruar të mbështesin punën e tyre duke dhënë të gjitha informacionet e kërkuara dhe duke garantuar qasjen në informacion menjëherë.

• Ligji Nr. 22/2018 për Strehimin Social²¹

Ky ligj synon të garantojë të drejtën për të aksesuar strehim dinjitoz dhe nga anëtarët e komunitetit LGBTI+ dhe Rom/Egjiptian. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse.

• Ligji Nr. 111/2017 “Për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti”²²

Ligji për Ndhimë Juridike Falas garanton ndihmë ligjore falas për individët viktime të dhunës në familje dhe që “kanë nevojë për ndihmë juridike në çështjet civile dhe administrative, por nuk kanë mjete të mjaftueshme për ta paguar këtë ndihmë juridike” (neni 13). Një ndryshim që iu bë ligjit prezantoi konceptin e klinikave lëvizëse juridike që duhet të ndihmojnë grupet e cenueshme në njësitë e qeverisjes vendore. Komisioni Shtetëror i Ndhimës Juridike (KSHNJ) është organi përgjegjës për ofrimin e ndihmës juridike. Shërbimet e ndihmës juridike falas kërkohen nga personat LGBTI+. Ligji nuk zbatohet plotësisht për shkak të vështirësive praktike për zbatimin e tij dhe mungesës së akteve nënligjore, disa prej të cilave nuk janë miratuar ende.

¹⁸Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 44/2015, Fletorja Zyrtare: <http://www.qbz.gov.al/Kode-pdf/Kodi%20i%20Proc%20Administrative%20azhurnuar-2016.pdf>.

¹⁹Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi i ndryshuar: <http://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20201020143441ligj%20nr.%20124%20dt.%2015.10.2020.pdf>

²⁰Ministria e Integritimit Evropian: Përafrimi i legjislacionit me *acquis-in* e BE-së, marrë nga: <http://www.integrimi.gov.al/programi/pefrafrimi-i-legjislacionit>

²¹LIGJ. Nr. 22/2018. PËR STREHIMIN SOCIAL. Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

²²Ligji për Ndhimë Juridike Falas, Ligji nr. 10039, datë 22.12.2008, ndryshuar për herë të fundit me Ligjin nr. 77/2014, datë 10.07.2014, Fletorja Zyrtare: <http://www.tlas.org.al/sites/default/files/ligji%20per%20ndihmen%20juridike.pdf>.

• **Ligji Nr. 69/2012, “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar”, më vonë i ndryshuar.**²³

Në Shqipëri, mbrojtja zyrtare në mjedisin shkollor garantohet nga dispozitat ligjore të LMD dhe të Ligjit Nr. 69/2012, Për Arsimin Parauniversitar.

Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar. Ligji për Arsimin Parauniversitar në Shqipëri (2013) në vijim të rekomandimeve të institucioneve të të drejtave të njeriut dhe në zbatim të Konventës për të Drejtat e Femijës, përfshiu për herë të parë edhe mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të orientimit seksual, por la jashtë për arsye që nuk dihen identitetin gjinor. Ndër të tjera ligji parashikon ngritjen e Komisioneve të Etikës pranë çdo shkolle për të trajtuar rastet e dhunës apo diskriminimit ndaj femijëve apo edhe mësuesve.

• **Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”**²⁴

Ligji për vetëqeverisjen vendore cakton detyrimet që kanë bashkitë, si njësitë e vetme administrative në nivel lokal përkundrejt banorëve të saj, përfshi edhe personat LGBTI+. Neni 3 i këtij ligji ndër të tjera, garanton se vetëqeverisja vendore duhet të bëhet “në respekt të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera.” Po ashtu, Neni 123 i të njëjtit ligj përcakton edhe përgjegjësinë e bashkive për të ofruar shërbime sociale në territorin e tyre për të gjithë banorët, përfshi edhe strehimin social.

• **Ligji nr.10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, më vonë i ndryshuar.**²⁵

Ligji për Gjendjen Civile, i ndryshuar në vitin 2013, në parim e lejon ndryshimin e shënimit të gjinisë dhe të emrit në dokumentet zyrtare të gjendjes civile. Ligji parashikon se emrat mund të ndryshohen nëse kanë kuptim të papërshtatshëm, që nënkupton emrat me karakter fyes, imoral ose racist, qesharak, që janë të vështirë për t'u shqiptuar ose të ngatërruar (neni 2), si dhe në rastin kur ka gabime materiale në regjistrë (neni 57/7). Ndryshimi duhet të certifikohet me anë të një akti juridik lëshuar nga një ent ligjor që është përgjegjës për këto akte (neni 9). Si emri ashtu edhe shënimi i gjinisë ndryshohet me vendim gjykate. Ndryshimi i emrit mbështetet në faktin se emri është i papërshtatshëm, ndërsa ndryshimi i shënimit të gjinisë bazohet në faktin se gjinia/seksi i personit është ndryshuar, që provohet me vërtetim nga mjeku. Shënimi i gjinisë nuk mund të ndryshohet me vetëdeklarim. Personi duhet të jetë në zotërim të një vendimi gjykate për të kërkuar njohjen zyrtare të emrit të ndryshuar dhe të gjinisë së ricaktuar. Ndryshimet pasqyrohen në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (neni 57/10). Sipas informacionit të marrë nga MB dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ka pasur vetëm një rast të njohjes zyrtare të gjinisë së ricaktuar, kërkuar nga një person interseks, ndërsa nuk ka pasur raste personash transgjinorë.

Për të mbështetur njohjen zyrtare të gjinisë së ricaktuar, në vitin 2015 Komisioni Evropian u rekomandoi autoriteteve të garantojnë ndryshimin e emrit dhe gjinisë në dokumentet zyrtare në një mënyrë të shpejtë, transparente dhe të aksesueshme.

• **Ligji Nr. 121/2014 “Për Azilin”, më vonë i zëvendësuar nga Ligji Nr. 10/2021.**²⁶

Në përkufizimin e refugjatëve, Ligji për Azilin përmban edhe kategorinë e “një anëtar të një grupi të veçantë social”, duke e konsideruar këtë si bazë për dhënien e statusit të refugjatit atyre që janë persekutuar për shkak se janë persona LGBT (nenet 3 dhe 4). Megjithatë, nuk ka asnjë të dhënë zyrtare publike për numrin e personave që kanë mundur ta përdorin përkatësinë si “anëtar/e i një grupi të veçantë social” si bazë për të fituar azilin ose mbrojtje të përkohshme për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor. OSIGj nuk figuron ndër bazat për kërkimin e azilit në ligjin për azilin. Rekomandohet që ligji të përmendë shprehimisht rastet e persekutimit për arsye të orientimit seksual ose identitetit gjinor.

• **Ligji Nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për Kujdesin Shëndetësor”, më vonë i ndryshuar.**²⁷

E drejta për kujdes shëndetësor është e garantuar në Kushtetutë. Kujdesi shëndetësor publik është përgjegjësi themelore e qeverisë dhe Ligji për Kujdesin Shëndetësor garanton të drejtën e shëndetit për të gjithë. Spitalet, klinikat dhe institucione të tjera shëndetësore, publike apo private, janë të hapura për publikun e gjerë. Personat në marrëdhënie pune paguajnë kontribute pranë Institutit të Sigurimeve Shëndetësore (ISSH), ndërsa shpenzimet për personat e papunë mbulohen nga shteti. I gjithë dokumentacioni legjislativ në fushën e kujdesit shëndetësor është gjenerik dhe nuk përmend në veçanti OSIGj-të ose nevojat shëndetësore të personave LGBTI+. Duke qenë se baza ligjore parashikon kujdesin shëndetësor për të gjithë, personat LGBTI+ përfitojnë nga shërbimi shëndetësor mbi të njëjtat baza si qytetarët e tjerë. Edhe LMD ndalon diskriminimin për shkak të OSIGj.

²³Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, Ligji nr. 69/2012, ndryshuar për herë të fundit me Ligjin nr. 56/2015, datë 28.5.2015, Fletorja Zyrtare: <http://www.qbz.gov.al/ligje.pdf/arsim/ligji%20per%20sistemin%20arsimor.pdf>

²⁴Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” https://www.rru.al/doc/Ligj_nr.139-2015_date_17.12.2015_Per_vetëqeverisjen_vendore.pdf

²⁵Ligji për Gjendjen Civile, Ligji nr. 10129, datë 11.5.2009, ndryshuar me Ligjin nr. 130/2013 date 25.4.2013, Fletorja Zyrtare: http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2013/PDF-2013/78-2013.pdf

²⁶Ligji për Azilin në Republikën e Shqipërisë, Ligji nr. 121/2014, Fletorja Zyrtare, https://www.parlament.al/wp-content/uploads/sites/4/2015/10/ligj_nr_121_dt_18_9_2014_19228_11.pdf.

²⁷Ligji për Shërbimin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, No10107, ndryshuar për herë të fundit me Ligjin nr. 76/2015, datë 16.7.2015, Fletorja Zyrtare: <http://www.qbz.gov.al/ligje.pdf/sigurime%20shendetesore/Ligj%20Nr%2010%20107.pdf>

E drejta për kujdesin shëndetësor riprodhues, sigurime shëndetësore dhe shëndetin mendor u njihet të gjithëve, por personat LGBTI+ nuk i gëzojnë ato në praktikë - personat gei dhe lesbike nuk kanë qasje në teknologjinë e riprodhimit të asistuar (TRA), personave transgjinorë nuk u ofrohet kirurgji për ricaktimin e seksit (KRS) në spitalet publike, dhe shpenzimet për KRS dhe TZH nuk mbulohen nga skemat e sigurimeve shëndetësore. Personat interseks i detyrojnë të bëjnë ndërhyrje mjekësore, çka është në kundërshtim me të drejtën e tyre për integritet trupor.

Personat LGBTI+ kanë të drejtë të përfitojnë nga shërbimet e kujdesit shëndetësor mbi të njëjtat baza si qytetarët e tjerë, por atyre u mungon qasja e plotë në shërbimet shëndetësore dhe vuajnë nga cilësia e dobët e shërbimeve. Të dhënat për klientët LGBTI+ mungojnë plotësisht, sepse OSIGJ-të nuk shënohet në kartelat mjekësore. Është e vështirë të hartohen politika për shëndetin e personave LGBTI+ në mungesë të statistikave. Zakonisht mjekët prezumojnë automatikisht se personi është heteroseksual, çka sjell që nevojat specifike shëndetësore që lidhen me OSIGJ-të mbeten pa u diskutuar. Vetëm testi vullnetar për HIV-in përmban pyetje për OSIGJ-në e personit.

Plani i Veprimit për Shëndetin Mendor për vitet 2013-2022 nuk i përmend personat LGBTI+ si grup i rrezikuar nga mendimet për vetëvrasje. Nuk është bërë ndonjë anketim shëndetësor për nevojat shëndetësore të personave LGBTI+ dhe programet e shkollave për profesionistët në fushën e shëndetësisë nuk trajtojnë të drejtat e personave LGBTI+ për kujdes shëndetësor.

• Plani Kombëtar i Veprimit për personat LGBTI+ në Republikën e Shqipërisë 2016-2020²⁸

Kuadri legjislativ i Shqipërisë kundër diskriminimit për shkak të OSIGJ mbështetet nga një Plan Kombëtar Veprimi (PKV) për të drejtat e personave LGBTI+ për periudhën 2016-2020. Ky është plani i dytë i veprimit pas planit të parë për periudhën 2012-2014. Një karakteristikë e veçantë e Planit të Veprimit 2012-2014 ishte forcimi i organizatave me fokus personat LGBTI+ dhe i kontributit që japin ato në përmirësimin e jetës së personave LGBTI+ në Shqipëri. Më konkretisht, hapat më të rëndësishëm në procesin e zbatimit të këtij plani përfshijnë:

- i. Angazhimi i ministrive të linjës, KMD, Zyrës së Avokatit të Popullit dhe organizatave ndërkombëtare;
- ii. Trajtimi i çështjeve LGBTI+ me donatorët, agjencitë, komunitetin ndërkombëtar në Shqipëri dhe Evropë;
- iii. Ofrimi i trajnimit për punonjësit e policisë dhe të arsimit;
- iv. Ndërveprimi dhe bashkëpunimi me OJQ të tjera të drejtave të njeriut;
- v. Kryerja e studimeve për kuadrin ligjor;
- vi. Propozime legjislative;
- vii. Ngritja e ndërgjegjësimit të publikut; dhe
- viii. Ofrimi i një strehe të sigurt në Tiranë për të rinjtë LGBTI+ që detyrohen të largohen nga shtëpia.

• Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Rom/Egjiptianëve dhe Egjiptjanëve në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020, miratuar me VKM Nr. 1072, datë 23.12.2015²⁹

Objektivat strategjikë të planit janë:

- Lehtësimi i mundësive për shfrytëzimin e barabartë të shërbimit të rregjistrimit civil dhe drejtësisë për Rom/Egjiptianët dhe egjiptianët.
- Rom/Egjiptianët dhe egjiptianët të gëzojnë akses dhe përfshirje të plotë në arsim cilësor duke mos qenë subjekt i diskriminimit dhe segregimit.
- Krijimi i mundësive të barabarta për punësimin formal të Rom/Egjiptianëve dhe egjiptianëve.
- Garantimi i një kujdesi mjekësor të aksesueshëm, të përballueshëm dhe të barabartë për Rom/Egjiptianët dhe egjiptianët.
- Përmirësimi i kushteve të strehimit për Rom/Egjiptianët dhe egjiptianët.
- Rritja e aksesit në programet e mbrojtjes sociale për anëtarë të komunitetit Rom/Egjiptian dhe Egjiptian.

²⁸Plani Kombëtar i Veprimit për personat LGBTI+ në Republikën e Shqipërisë 2016-2020; <http://ëëë.sociale.gov.al/dokumente/strategji>.

²⁹https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/03/Plani_kombetar_i_veprimit_per_integrimin_e_Romeve_dhe_Egjiptianeve_2016-2020.pdf

6. SI DHE KU MUND TË RAPORTOJMË DISKRIMINIMIN E SHUMËFISHTË?

Nisur nga raporti vjetor i Aleancës LGBTI+ për vitin 2019, rezultojnë që nga 304 raportime në pyetësoin e zhvilluar nga ne për diskriminimin, vetëm 34 raste (11 %) kanë raportuar dhunën me bazë orientimin seksual dhe identitetin gjinor në institucionet përkatëse, kurse 270 raste (89%) nuk janë raportuar.

Në krahasim me vitin 2018, ku vetëm 5 raste nga 421 kanë raportuar dhunën, gjatë vitit 2019 janë raportuar 29 raste më shumë pranë institucioneve. Rritja e raportimit të rasteve tregon rëndësinë e ndërgjegjësimit të komunitetit LGBTI+ për të njohur të drejtat e tyre dhe për të vënë para përgjegjësi organet ligjzbatuese.

Sipas përgjigjeve të komunitetit gjatë 2019 rezultojnë se 121 raste (40%) deklarojnë se e kanë më të përshtatshme dhe më shumë besim për të raportuar rastet e diskriminimit në organizatat që mbrojnë të drejtat e komunitetit LGBTI+; 79 raste (26%) deklarojnë se e kanë më të përshtatshme për të raportuar nëpërmjet platformave online; 64 raste (21%) deklarojnë se e kanë më të përshtatshme të raportojnë në polici; si dhe 40 raste (13%) e kanë më të përshtatshme të Komisioneri për Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

RAPORTO!

Disa nga institucionet ku mund të orientoheni për të raportuar rastet e diskriminimit:

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Nëse përballeni me diskriminim nga institucionet shtetërore si shkollat, univeristet, policia, zyrat e punësimit etj, ose nga bizneset private që ofrojnë të mira dhe shërbime duhet t'i drejtoheni zyrës së Komisionerit Kundër Diskriminimit. Raportimin mund ta bëni në dy mënyra duke u paraqitur pranë zyrës së komisionerit në Rrugën e Durrësit pranë Ministrisë së Arsimit ose duke plotësuar formularin e raportimit online; <https://www.kmd.al/?lang=en>. Zyrat e Komisionerit mund ti gjeni dhe në qytetet e Shkodrës, Korçës dhe Fierit.

Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat

Nëse përballeni me diskriminim nga punonjësit e Policisë së shtetit apo nuk merrni shërbimin e duhur prej tyre mund ti drejtoheni SHÇBA. Për ta pasur më lehtë procedurën e ankimit duhet të tregoheni të vëmendshëm dhe të rregjistroni numrin personal të policit që ju ka diskriminuar ose nuk ju ka dhënë shërbimin e duhur. Nr personal gjendet në anën e majtë të uniformës. Ankesat mund të bëhen përmes postës elektronike, email: ankesa@shcba.gov.al ose Linjës së gjelbër 0800 90 90 pa pagesë.

Avokati i Popullit: Institucioni i Avokatit të Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Avokati i Popullit vepron në bazë të ankesës apo kërkesës së paraqitur pranë tij. Ai vepron edhe me nismën e vet, për raste të veçanta, të bëra publike, por gjithmonë duhet të marrë më vonë pëlqimin e të interesuarit ose të dëmtuarit. Ankesat pranë institucionit të Avokatit të Popullit mund të bëhen online në websitin www.avokatiipopullit.gov.al ose pranë zyrave: Rruga Vllazën Huta, Tiranë.

Agjencia e Mediave Audiovizuale (AMA): AMA është një autoritet rregullator i pavarur i cili ka për qëllim rregullimin, licencimin dhe monitorimin e aktivitetit të televizioneve dhe radiave në Republikën e Shqipërisë. Një nga organet kryesore të AMA është dhe Këshilli i Ankesave, i cili ka për objekt të punës mbikëqyrjen e zbatimit të kodit dhe rregulloreve të miratuara nga AMA, që kanë të bëjnë sidomos me respektimin e dinjitetit e të drejtave të tjera themelore të njeriut, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e të miturve, të drejtës për informacion dhe sensibilizimit të opinionit publik, lidhur me respektimin e normave morale dhe etike në programet e ofruesve të shërbimeve audiovizive. Nëse ju përballeni me emisione që përmbajnë gjuhë urrejtje ose fyese ndaj komuniteteve tuaja mund të raportoni përmes një emaili në adresën: Info@ama.gov.al. Në email duhet të përfshini emrin e emisionit, ditën dhe orën kur është transmetuar dhe të përshkruani shkurtimisht shqetësimin tuaj. Ankesat tuaja diskutohen në Këshillin e Ankesave ku merren dhe masat ndaj emisioneve me përmbajtje diskriminuese.

Policia e Shtetit: Nëse përballeni me dhunë në familje, shkollë, lagje ose çdo hapësirë tjetër private ose publike është shumë e rëndësishme të kontaktoni menjëherë me numrin e emergjencës 112. Policia ka të drejtën dhe detyrimin të ndërhyjë dhe t'ju ndihmojë dhe në rastet kur familja juaj ju mban të izoluar për shkak të orientimit tuaj seksual ose identitetit gjinor ose kur prindërit ju detyrojnë të merrni kura për arsytet e mësipërme.

7. LISTA E ORGANIZATAVE KRYESORE QË OFROJNE SHËRBIME PËR KOMUNITETIN LGBTI+ DHE ROM/EGJIPTIAN NË SHQIPËRI:

Emri: Aleanca kundër diskriminimit LGBT

E-mail: info@aleancalgbt.org

Faqja e internetit: <http://www.aleancalgbt.org/>

Përshkrim i shkurtër i aktiviteteve të organizatës:

Aleanca Kundër Diskriminimit të LGBT është një organizatë jo-qeveritare shqiptare që parashikon një shoqëri të lirë, të hapur, dhe të barabartë për të gjithë identitetet seksuale e gjinore njerëzore. Aleanca ka për qëllim krijimin dhe fuqizimin e komunitetit shqiptar LGBT, mbrojtjen e të drejtave të tij dhe luftën kundër diskriminimit të bazuar tek orientimi seksual dhe identiteti gjinor. Aleanca nisi aktivitetet e saj në mars të vitit 2009, kur një grup vullnetarësh LGBT filluan punën mbi hartimin e programeve dhe aktiviteteve për komunitetin, dhe u regjistrua si organizatë jo-qeveritare në nëntor 2009.

Programet dhe aktivitetet e Aleancës LGBT përfshijnë:

- Fuqizim i komunitetit LGBT në Shqipëri
- Organizim i eventeve sociale të vazhdueshme për komunitetin me synim njohjen mes tyre dhe informimin për çështje LGBT (grupe javore diskutimi, festa javore, shfaqje filmash, pikniqe, skuadër futbollit për vajza etj).
- Ndërlidhje e komunitetit shqiptar LGBT me ato në rajon (p.sh. pjesëmarrje në Gay Pride në Kroaci, informim i vazhdueshëm për zhvillime në rajon).
- Mbështetje për personat LGBT dhe familjarët e tyre që duan të ndajnë problemet me dikë që mund t'i kuptojë dhe ndihmojë.
- Advokaci dhe lobim me aktorë të tjerë të shoqërisë civile, aktorë qeveritarë, dhe bashkësinë ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT në Shqipëri.
- Ndërgjegjësim dhe edukim publik
- Fushata publike informimi nëpërmjet shpërndarjes së materialeve informuese (fletushka, postera, broshura) në formë elektronike dhe duke ndaluar njerëzit në rrugë (p.sh. Doktorët e Homofobisë).
- Prezantime dhe leksione në universitete mbi historikun e lëvizjeve për të drejtat e njerëzve LGBT, për komunitetin LGBT në Shqipëri etj.
- Pjesëmarrje në emisione televizive dhe radiofonike.
- Botime shkrimesh dhe intervista në median e shkruar
- Advokaci dhe lobim me aktorë të tjerë të shoqërisë civile, aktorë qeveritarë, dhe bashkësinë ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT në Shqipëri.

Emri: Ambasada PINK

E-mail: info@pinkembassy.al

Faqja e internetit: www.pinkembassy.al

Tel: + 355 (0) 4 2265741

Cel: + 355 672075330

Ambasada PINK / LGBT Pro Shqipëri është një organizatë jo-fitimprurëse e cila punon për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të personave lezbike, gej, biseksualë, transgjinorë, interseks dhe queer në Shqipëri.

Me përpjekjet e saj dhe me mbështetjen e partnerëve kombëtarë e ndërkombëtarë, në 17 Maj 2010 Ambasada PINK / LGBT Pro Shqipëri realizoi “Festivalin e Diversitetit”, i pari aktivitet publik i realizuar në vend në një mjedis të hapur. Ky ishte një nga momentet më vendimtarë për njohjen e gjerë të kauzës LGBT në vend. Ambasada PINK / LGBT Pro është anëtare e organizmave ndërkombëtare si ILGA Europe dhe IGLYO si dhe e rrjeteve të organizatave LGBT si Rrjeti Rajonal kundër Homofobisë dhe Transfobisë etj. Prej vitit 2014 Ambasada PINK / LGBT Pro po punon për realizimin e Pride-t të parë LGBT në Shqipëri, në 17 Maj, si dhe për avancimin e të drejtave të personave LGBT me politika qendrore dhe lokale, rritje kapacitetesh, lobim dhe advokim, programme trajnimi etj.

Fushat e përparësisë janë:

- Zbatimi i plotë i Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe njohja ligjore e personave LGBT dhe garantimi i barazisë së tyre të plotë;
- Emancipimi i ligjit shqiptar në raport me njohjen dhe shprehjen e gjinisë;
- Zbatimi i planit të masave kombëtare nga Qeveria e Shqipërisë për avancimin e të drejtave LGBT;
- Krijimi i qyteteve miqësore ndaj personave LGBT (qytetet ylber), për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave LGBT në nivel lokal;
- Reformimi i sistemit arsimor në Shqipëri për integrimin e plotë të çështjeve LGBT, si çështje e të drejtave të njeriut, në kurrikulat e shkollave të vendit për një mirë-informim të brezave të rinj mbi çështje të orientimit seksual dhe identitetit gjinor;
- Mbrojtja e fëmijëve dhe adoleshentëve LGBT nga bulzimi dhe dhuna në shkolla si dhe luftimi i këtij fenomeni;
- Mbrojtja e personave LGBT nga dhuna e krimit e urrejtjes dhe krijimi i një mjedisi dhe përjasjeje pozitive nga Policia e Shtetit;
- Krijimi i mjediseve pranuese dhe pozitive brenda familjeve shqiptare me anëtarë LGBT etj;
- Garantimi i shërbimeve mjekësore të përshtatshme për personat e LGB dhe krijimi i kushteve për ndryshimin dhe njohjen e gjinisë për personat transgjinorë.

Emri: OMSA (Open Mind Spectrum Albania)

E-mail: omsa.albania@gmail.com

Faqja e internetit: www.omsalbania.org (ne punim)

Tel (mob): +355693953920

Përshkrim i shkurtër i aktiviteteve të organizatës:

OMSA (Open Mind Spectrum Albania) u krijua zyrtarisht në vitin 2013 dhe ka zhvilluar projekte dhe aktivitete në fushën e punës në komunitet dhe advokimit. OMSA synon një shoqëri ku çdo individ, pa marrë parasysh orientimin seksual, identitetin gjinor, gjininë, ngjyrën, moshën, statusin shoqëror, statusin martesor, aftësitë, statusin shëndetësor, përkatësinë etnike, gëzon të drejta dhe liri të plota, sigurimin social, shëndetësor etj. OMSA ka një eksperiencë të gjerë të punës së saj me prindërit e personave LGBTI+ dhe është pjesë e rrjeteve kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare për të drejtat e komunitetit LGBTI+.

Në fillimet e saj, dhe më tej, OMSA zhvilloi një sërë trajnimesh me prindërit dhe të afërmit e njerëzve LGBTI+. Qëllimi i këtyre aktiviteteve ishte të siguronte informacion të besueshëm, të mbështeste familjet në procesin e tyre të njohjes, pranimit dhe daljes hapur të fëmijëve të tyre LGBTI+.

Në përpjekjet e saj për të zhvilluar një program advokimi, OMSA ka filluar në vitin 2016 një projekt që adreson pjesëmarrjen politike dhe përfaqësimin e njerëzve LGBTI+ në Shqipëri. Qëllimi kryesor i projektit është rritja e pjesëmarrjes së personave LGBTI+ në jetën politike dhe çështjet kryesore të lidhura me personat LGBTI+ në arenën politike para zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe pas zgjedhjeve.

OMSA për të realizuar këtë vizion punon për:

- Promovimin dhe përmirësimin e gjendjes ligjore dhe sociale të grupeve të minoriteteve në Shqipëri, si Rom/ Egjiptianë, egjiptian, LGBTQI, me aftësi të kufizuara, të rinj me probleme si droga dhe AIDS, të drejtat e grave dhe të fëmijëve.
- Rritjen e dukshmërisë me kryerjen e fushatave për ndërgjegjësimin dhe informimin mbi çështjet e komuniteteve të përmendura më lart.
- Përgatitjen dhe sigurimin e trajnimeve profesionale, kurseve arsimore, seminareve, workshopeve, konferencave etj.
- Monitorimin dhe raportimin e shkeljeve të të Drejtave të Njeriut, për të rritur mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe në veçanti sundimin e ligjit.
- Mbështetjen në ngritjen e kapaciteteve, aftësive dhe njohurive të individëve, grupeve dhe organizatave qëllimet e të cilave përkojnë me organizatën tonë.

Emri: STREHA LGBT
E-mail: info@strehalgbt.al
Faqja e internetit: www.strehalgbt.al

Përshkrim i shkurtër i aktiviteteve të organizatës:

“STREHA” është qendra e parë rezidenciale në Shqipëri që i vjen në ndihmë komunitetit LGBTI+ në rastet e emergjencave në aspektin e strehimit.

Streha nisi aktivitetet e saj si projekt pilot që prej Dhjetor 2014 duke operuar si projekt pilot i përbashkët i dy organizatave në fushën e të drejtave të komunitetit LGBTI+, nga “Aleanca Kundër Diskriminimit të LGBT” dhe “ProLGBT” (Të Bashkuar Pro Kauzës LGBT). Që prej Nëntorit 2015, Qendra Streha u themelua si entitet i pavaruar në kuadër të qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë së konsolidimit të shërbimit për komunitetin LGBTI+ në risk.

Qendra “Streha” është një shërbim tranzitor për të gjithë të rinjtë LGBTI+ 18-25 vjeç që hasin dhunë, diskriminim dhe nevojë për strehim për shkak të orientimit të tyre seksual. Streha ofron shërbim ri-integrimi 24 orë në 7 ditë të javës për të rinjtë LGBTI+ të pastrehë dhe në risk përjashtimi social nëpërmjet 8 personave të stafit. Ajo ka një kapacitet prej 8 shtretërisht dhe synon të ofrojë ndihmë dhe shërbim për të rinjtë LGBTI+ të pastrehë, si dhe punon për ri-integrimin dhe fuqizimin e tyre si pjesë e shoqërisë.

Ndërhyrjet kryesore që realizon streha janë:

- Shërbimi bazë
- Akomodim
- Ushqim
- Asistence mjekësore
- Asistence për punësim
- Asistence për arsim/kurse profesionale
- Këshillim karriere
- Këshillim psikologjik
- Këshillim në grup
- Negocim me familjet
- Aktivitete psiko-edukuese
- Aktivitete socio-kulturale

2. Koordinim terreni

- Koordinim me institucionet për përfshirjen e shërbimit në mekanizmin ekzistues të referimit të dhunës
- Koordinim me komunitetin
- Ndjekje e rasteve në distancë (komunitet)

Që prej tetorit 2017, Streha ka filluar të punojë për ndjekjen e rasteve në distancë. Ngritja e udhëzuesve dhe protokollit të ndjekjes janë hapat e para për të vijuar këtë shërbim.

Emri: Të bashkuar Pro Kauzës LGBT në Shqipëri (ProLGBT)
E-mail: prolgbtalbania@gmail.com
Faqja e internetit: www.historia-ime.com

Përshkrim i shkurtër i aktiviteteve të organizatës:

“Të bashkuar PRO kauzës LGBT në Shqipëri” ose shkurt ProLGBT nisi si një iniciativë vullnetare e një grupi të vogël djemsh dhe vajzash. Që prej vitit 2011, aktivistët e ProLGBT kanë punuar të rrisin vizibilitetin e komunitetit LGBT në vend, të kontribuojnë për fuqizimin e komunitetit dhe të llojnë për të drejtat e tyre brenda dhe jashtë vendit.

Besojmë se Shqipëria është duke jetuar një moment të pazëvendësueshëm të Lëvizjes për të Drejtat e LGBT, por nuk mund të konsiderohet një vend demokratik që respekton të drejtat e njeriut pa respektuar dhe garantuar edhe të drejtat e komunitetit LGBT. Për ne fuqizimi i komunitetit LGBT në vend është çelësi kryesor i suksesit dhe përmirësimit të jetëve të atyre mijëra djemve e vajzave që ende jetojnë me frikë për atë që janë, në mes të një shoqërie ekstremisht armike ndaj të qenit ndryshe.

Pro LGBT që prej vitit 2012 menaxhon portalin për të drejtat e njeriut - Historia Ime, e cila shpesh është bërë burimi kryesor i medias shqiptare dhe të huaj për shpërndarjen e informacioneve apo ngjarjeve në lidhje me komunitetin LGBT.

Programet dhe aktivitetet e ProLGBT përfshijnë:

- Ndërgjegjësimin e opinionit publik
- Promovon dinjitetin, barazinë dhe të drejtat e personave LGBT në Shqipëri.
- Ndërgjegjëson dhe edukon publikun e gjerë dhe institucionet publike për të drejtat e personave LGBT.
- Lobimin dhe advokimin për çështjet LGBTI+ në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Ndikon në përmirësimin e politikave dhe ligjeve në favor të komunitetit LGBT.
- Informon institucionet publike, Qeverinë shqiptare dhe organizatat ndërkombëtare për situatën e të drejtave të komunitetit LGBT në vend.
- Punon për përmirësimin e legjislacionit, politikave, dhe standarteve për të drejtat LGBT.
- Punon për edukimin e medias mbi çështjet LGBT.
- Menaxhon medien për komunitetin LGBT në Shqipëri nëpërmjet portalit Historia Ime.
- Bën trajnime me përfaqësues të medias mbi gjuhën diskriminuese dhe terminologjinë LGBT.
- Asiston komunitetin LGBT dhe vendos në dispozicion të tyre mjete, që bëjnë të mundur rritjen e pjesëmarrjes së këtij komuniteti në jetën publike të vendit.

Emri: Lëvizja Rinore Egjiptiane-Rome

E-mail: erviscota12@gmail.com

Nr tel: +355 69 62 98 289

“Lëvizja Rinore Egjiptiane-Rome” është një organizatë rinore jo-fitimprurëse e njohur juridikisht në 11.02.2014. Objektivi i shoqatës “Lëvizja Rinore Egjiptiane-Rome” do të jetë:

- Ardhja në ndihmë ndaj komuniteteve Egjiptiane dhe Rome.
- Ruajtja, përkujdesja, zhvillimi dhe hulumtimi i traditave të së kaluarës, kulturës dhe krijimtarisë popullore të Egjiptianëve dhe Romëve.
- Mbrojtja dhe afirmimi i të drejtave dhe lirive njerëzore dhe qytetare dhe në kuadër të tyre edhe të tërë Egjiptianëve dhe Romëve, në të gjitha qytetet e Shqipërisë dhe më gjerë, që garantojnë me Deklaratën e OKB-së dhe akte të tjera ndërkombëtare.
- Ngritja e qendrave kulturore-edukative, bibliotekë, internet, etj; veçanërisht për rininë, duke i ardhur sa më shumë në ndihmë formimit të tyre kulturor dhe profesional. 4-Ngritja e nivelit arsimor dhe formimit profesional të rinjve Egjiptian dhe Rom .
- Të organizojë aktivitete dhe konkurse të ndryshme.
- Realizimi i projekteve që kanë ndikim të rëndësishëm social-politik mbi popullsinë e këtyre dy komuniteteve.
- Angazhimi në veprimtari humanitare dhe raste fatkeqësish.
- Krijimi i mjeteve të shkruara dhe vizive në funksion të këtyre objektivave.

Emri: Qendra T'REJA

E-mail: qendratreja@gmail.com

Qendra T'REJA është krijuar si bashkësi e vlerave dhe normave më të hapura shoqërore. Misioni i saj është fuqizimi i familjeve të varfëra, në nevojë, për të kërkuar dhe realizuar të drejtat e tyre duke ndërmarrë veprime dhe iniciativa të cilat lehtësojnë aksesin në shërbime dhe në të drejta, me qëllim përmirësimin e jetesës, nivelit arsimor, strehimit, shëndetit dhe pozitës së tyre në shoqëri.

8. BIBLIOGRAFIA

- Ministria e Mirëqenies Sociale, Rinisë dhe Sporteve (2016) Plani Kombëtar i Veprimit për personat LGBTI në Shqipëri për 2016-2020, aksesuar më 10.08.2016, gjendet në: <http://www.sociale.gov.al/al/dokumente/strategji>.
- “The experience of discrimination on multiple grounds”, September 2011, Maria Hudson Policy Studies Institute, University of Westminster, fq. 3 http://www.acas.org.uk/media/pdf/0/3/0112_Multidiscrim_Hudson-açesible-versionApr-2012.pdf
- Raporti analitik mbi gjetjet e studimit cilësor mbi situatën e personave LGBTI në Shqipëri, Serbi dhe Maqedoninë e Veriut, Civil Rights Defenders 2019.
- Barabaripe Young Roma speak about multiple discrimination, Written by Lucie Fremlova, Mara Georgescu, Gábor Hera, Laura-Greta Marin, Goran Miletic Edited by Lucie Fremlova, Mara Georgescu. <https://rm.coe.int/168046cfd5>
- National Democratic Institute (2015) Public Opinion Poll Western Balkans on LGBTI issues (Anketim publik në Ballkanin Perëndimor për çështjet LGBTI), gjendet në: https://www.ndi.org/LGBTI_Balkans_poll, aksesuar më 10.08.2016.
- Poni, Merita ,TË JESH LGBTI NË EVROPËN LINDORE: RAPORTI PËR SHQIPËRINË; <https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/te-jesh-lgbti-ne-evropen-lindore--raporti-per-shqiperine.html>
- Poni, Merita dhe Altin Hazizaj (2016b) Diskriminimi i adoleshentëve LGBTI në shkolla: një studim në gjashtë bashki. Tiranë: Botimet e Ambasadës PINK (në proces botimi). Për rezultatet paraprake shih: gjendet në: <http://www.PINKembassy.al/studimi-i-ambasades-PINK-adoleshentet-lgbt-viktima-te-dhunes-bashkemoshatarebulizmit>.
- Voko, Kristina (2013) Aksesit në shërbime dhe cilësia e kujdesit shëndetësor për personat LGBT në Shqipëri – Raport Teknik, Avokati i Popullit, Tiranë)
- Loloçi, Krenar (2014). Study on Homophobia, Transphobia and Discrimination on Grounds of Sexual Orientation and Gender Identity. Legal Report: Albania (Studim për Homofobinë, Transfobinë dhe Diskriminimin për shkaqe të orientimit seksual dhe Identitetit gjinor. Raport Ligjor: Shqipëria, porositur nga Ambasada Britanike Tiranë.
- Luft Aliza, Filipović Senka, Miller Kellea dhe Schneeweis Irene (2015) Western Balkans LGBTI: Landscape Analysis of Political, Economic and Social Conditions (LGBTI në Ballkanin Perëndimor: Analizë panoramike e kushteve politike, ekonomike dhe shoqërore). Fondacioni Astraea i Lesbikeve për Drejtësi, gjendet në: <https://www.astraeafoundation.org/uploads/files/Reports/Astraea%20Western%20Balkans%20Landscape%202015.pdf>.
- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (2015) Rezolutë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut të personave që i përkasin komunitetit LGBTI. Gjendet në: https://www.parlament.al/epcontent/uploads/2016/01/rezoluta_per_komunitetin_lgbt_dt_7_5_2015.pdf
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (2016) Raport i KMD për vitin 2019. <https://www.kmd.al/raporte-vjetore/?lang=en>
- Balli, Brikena (2015) Zvogëlimi i dhunës ndaj grave me fokus në komunitetin LGBT në Shqipëri, Tirana: Alliance against Discrimination of LGBT, gjendet në: <http://historia-ime.com/ep-content/uploads/2015/12/Libri-Anglisht.pdf>, aksesuar më 25.01.2017.
- Ligjet:
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji nr.9904, datë 21.4.2008, ndryshuar për herë të fundit në vitin 2016 me Ligjin nr.76/2016, datë 22/7/2016. Fletorja Zyrtare, gjendet në: http://www.pp.gov.al/ëeb/kushtetuta_2016_1082.pdf, aksesuar më 20.08.2016.
- Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, nr. 10221, datë 4.2.2010. Fletorja Zyrtare, gjendet në: <http://www.kmd.al/?fq=brenda&gj=gj1&kid=110>, aksesuar më 20.06.2016.
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 7895, datë 27 janar 1995, ndryshuar për herë të fundit në vitin 2013, Fletorja Zyrtare, gjendet në: <http://www.qbz.gov.al/Kode-pdf/Kodi%20Penal-2014.pdf>, aksesuar më 11.08.2016.
- Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, ndryshuar për herë të fundit në vitin 2015. Fletorja Zyrtare, gjendet në: , <http://www.qbz.gov.al/Kode-pdf/Kodi%20i%20Punes-2016-qershor.pdf>, aksesuar më 12.08.2016.
- Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 44/2015. Fletorja Zyrtare, gjendet në: http://www.erru.al/doc/Kodi_i_Procedurave_Administrative_2015.pdf, aksesuar më 14.08.2016.
- Kodi i Procedurave Civile të Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 8116, datë 23.3.1996, ndryshuar për herë të fundit në vitin 2012. Fletorja Zyrtare, gjendet në: <http://www.qbz.gov.al/Kode-pdf/Kodi%20i%20Procedures%20Civile-2012.pdf>, aksesuar më 14.08.2016.
- Ligji për Ndihmë Juridike Falas, Ligji nr. 10039, datë 22.12.2008, ndryshuar për herë të fundit me Ligjin nr. 77/2014, datë 10.07.2014. Fletorja Zyrtare, gjendet në: <http://www.tlas.org.al/sites/default/files/ligji%20per%20ndihmen%20juridike.pdf>, aksesuar më 15.08.2016.
- Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 9062 date 8.5.2003, ndryshuar për herë të fundit me Ligjin nr.134/2015, datë 5.12.2015. Fletorja Zyrtare, gjendet në: <http://www.qbz.gov.al/Kode-pdf/Kodi%20i%20Familjes-%20i%20azhurnuar%202016.pdf>, aksesuar më 13.08.2016.

- Ligji për Gjendjen Civile, Ligji nr.10129, datë 11.5.2009, ndryshuar me Ligjin nr.130/2013 date 25.4.2013, Fletorja Zyrtare, gjendet në: http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2013/PDF-2013/78-2013.pdf, aksesuar më 20.08.2016.
- Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, Ligji nr.69/2012, ndryshuar për herë të fundit me Ligjin nr.56/2015, datë 28.5.2015, Fletorja Zyrtare, gjendet në: <http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/arkiva/dok-0029.pdf>, aksesuar më 14.08.2016.
- Ligji për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, nr. 10107, ndryshuar për herë të fundit me Ligjin nr.76/2015, datë 16.7.2015, Fletorja Zyrtare, gjendet në: <http://www.qbz.gov.al/ligje.pdf/sigurime%20shendetesore/Ligj%20Nr%2010%20107.pdf>, aksesuar më 21.08.2016.
- Ligji “Për sigurimin e detyrueshëm në sistemin shëndetësor të Republikës së Shqipërisë”, nr. 10383, datë 24.2.2011, ndryshuar për herë të fundit më 17.12.2015, Fletorja Zyrtare, gjendet në: <http://www.qbz.gov.al/ligje.pdf/sigurime%20shendetesore/Ligj%20Nr%2010%20383.pdf>, aksesuar më 23.08.2016.
- Ligji për Shëndetin Publik, nr. 10,138, datë 11.5.2009, aksesuar më 24.08.2016, gjendet në: <http://www.ishp.gov.al/ep-content/uploads/2015/ligjet/Ligji-i-shendetit-publik.pdf>.
- Ligji Për Parandalimin dhe Kontrollin e HIV/AIDS-it, nr. 9952, datë 14.7.2008, gjendet në: http://www.shendetesia.gov.al/files/userfiles/Baza_Ligjore/Ligje/35.pdf, aksesuar më 25.08.2016.
- Ligji për Azilin në Republikën e Shqipërisë, Ligji nr. 121/2014, Fletorja Zyrtare, gjendet në: https://www.parlament.al/ep-content/uploads/sites/4/2015/10/ligj_nr_121_dt_18_9_2014_19228_11.pdf, aksesuar më 23.08.2016.
- Ligji për Mediat Audio-vizive në Republikën e Shqipërisë, Ligji nr. 97/2013, datë 2013, gjendet në: http://www.inovacioni.gov.al/files/pages_files/183909149-LIGJI-Nr-97-2013-PER-MEDIAT-AUDIOVIZIVE-NE-REPUBLIKEN-E-SHQIPERISE1.pdf, aksesuar më 20.10.2016.